

# DEKLARATË PËR TRANSPARENÇË PARLAMENTARE

## Përmbledhje ekzekutive

### Qëllimi

Deklarata për Transparencë Parlamentare<sup>1</sup> është thirrje e organizatave të shoqërisë civile për monitorimin parlamentar (OMP) drejtuar parlamenteve, për një përkushtim më të madh në transparencë dhe angazhim qytetar në punën parlamentare. OMP-të gjithnjë e më shumë po vlerësohen për rolin e tyre të rëndësishëm që luajnë për të siguruar që informatat parlamentare janë më të qasshme për qytetarët, për të fuqizuar kapacitetin e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset parlamentare, si dhe për të rritur llogaridhënien parlamentare. Gjersa OMP-të kanë interes të fortë për avokuar për qasje më të madhe në informata të qeverisë dhe parlamenteve, ato gjithashtu njohin nevojën për dialog në çështjen e reformave parlamentare. Kjo Deklaratë nuk synon vetëm të bëjë thirrje për veprim, por edhe të shërbejë si bazë për dialog ndërmjet parlamenteve dhe OMP-ve për avancimin e transparencës parlamentare, si dhe të sigurojë se kjo transparencë çon në angazhim më të madh qytetar, institucione përfaqësuese më të përgjegjshme dhe, përfundimisht, një shoqëri më demokratike.

### Historiku

Kjo Deklaratë, e cila është hartuar dhe mbështetur në një varg dokumentesh të miratuara nga komuniteti ndërkombëtar parlamentar, fillimisht është diskutuar në konferencën e liderëve të OMP-ve dhe është bashkë organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Fondacioni Sunlight dhe Rrjeti i Transparencës Legjislative në Amerikën Latine në Uashington. Konferenca u mbajt nga 30 prilli deri më 2 maj 2012, me mbështetje të Rrjetit Omidyar, Institutit për Shoqëri të Hapur, Shoqata Kombëtare për Demokraci, Instituti i Bankës Botërore dhe Ambasada e Meksikës në SHBA. Një version i azhurnuar i Deklaratës që pasqyron konsensusin e përgjithshëm të pjesëmarrësve të konferencës pastaj është rishikuar në Konferencën e të Dhënave Transparente Legjislative në Paris, të organizuar nga *Regards Citoyens*, *Centre d'études européennes de Sciences Po*, dhe *Medialab Sciences Po*, nga 6 deri 7 korrik 2012. Ky draft është vënë në dispozicion për komente publike në internet nga 11 qershori deri më 31 korrik 2012. Versioni përfundimtar i Deklaratës, i cili gjendet në [OpeningParliament.org](http://OpeningParliament.org) është lansuar në Konferencën Botërore për E-Parlamentin në Romë në Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë, me 15 shtator 2012.

### Fushëveprimi

**Promovimi i një kulture të transparencës:** Informatat parlamentare i përkasin publikut.

Informatat parlamentare do të mund të ripërdoren apo ribotohen nga qytetarët sipas kufizimeve të ngushta të përcaktuara me ligj. Për të bërë të mundur një kulturë të transparencës parlamentare, parlamenti duhet të miratojë rregulla për të siguruar pjesëmarrje përfshirëse të qytetarëve dhe një shoqëri të lirë civile, për të mundësuar monitorim efektiv parlamentar, si dhe për t'i mbrojtur fuqishëm këto të drejta përmes rolit të tij të mbikëqyrjes. Parlamenti gjithashtu do të sigurojë që qytetarët të kenë mundësi të referimit ligjor për

---

<sup>1</sup> Për një përmbledhje të praktikave më të mira dhe komentareve për Deklaratën, ju lutem shihni: <http://www.openingparliament.org/declaration>

zbatimin e të drejtës së tyre në qasje në informata parlamentare. Parlamenti ka një obligim afirmativ që të promovojë të kuptuarit qytetar të funksionimit parlamentar dhe t'i ndajë praktikat e mira me parlamentet tjera për të rritur transparencën e tyre. Parlamenti do të punojë bashkërisht me OMP-të dhe qytetarët për të siguruar që informatat parlamentare janë të plota, të sakta dhe se jepen në kohë.

**Zhvillimi i transparencës për informatat parlamentare:** Parlamenti duhet të miratojë politika të cilat sigurojnë publikim proaktiv të informatave parlamentare, si t'i rishikojë këto politika kohë pas kohe për t'i shfrytëzuar përparësitë e praktikave të evoluuara të mira. Informatat parlamentare përfshijnë informata për rolet dhe funksionet parlamentare, si dhe informatat e prodhuara gjatë tërë procesit legjislativ, duke përfshirë tekstin e legjislacionit të aprovuar dhe ndryshimeve, votat, agjendat dhe oraret parlamentare, procesverbalet e seancave plenare dhe të komisioneve, informatat historike, si dhe të gjitha informatat tjera që janë pjesë e shënimeve parlamentare, siç janë raportet e krijuara për parlamentin apo nga ai. Parlamenti do të sigurojë informata për historikun, aktivitetet dhe punët e deputetëve, duke përfshirë informata të mjaftueshme në mënyrë që qytetarët të nxjerrin vlerësime të informuara lidhur me integritetin dhe ndershmërinë e tyre, si dhe konfliktet e mundshme të interesit.

**Lehtësimi i qasjes në informata parlamentare:** Parlamenti duhet të sigurohet që informatat janë përgjithësisht të qasshme për të gjithë qytetarët pa diskriminim dhe përmes kanaleve të shumta, duke përfshirë vëzhgimet personale, mediat e shtypura, radion, si dhe transmetimet e drejtpërdrejta dhe me kërkesë dhe transmetimin në internet. Qasja fizike në parlament do të sigurohet për të gjithë qytetarët, gjithnjë duke pasur parasysh kufizimet e hapësirës dhe ato të sigurisë, me politika të përkufizuara qartë dhe në dispozicion të cilat sigurojnë qasje për mediat dhe vëzhguesit. Informatat parlamentare gjithashtu duhet të jenë në dispozicion pa pagesë, në të gjitha gjuhët zyrtare dhe të punës, si dhe përmes përmbledhjeve në gjuhë të thjeshtë, gjë që siguron që informatat parlamentare janë të kuptueshme për të gjitha kategoritë e qytetarëve.

**Mundësimi i komunikimit elektronik të informatave parlamentare:** Informatat parlamentare do të postohen në internet në formate të hapura dhe të strukturuar që bëjnë të mundur që qytetarët t'i analizojnë dhe ripërdorin këto informata duke shfrytëzuar të gjitha mjetet teknologjike. Informatat parlamentare do të lidhen me informatat përkatëse dhe të kenë mundësi kërkimi të lehtë, si dhe të mund të shkarkohen në tërësi ashtu që të nxitet zhvillimi i teknologjive të reja për hulumtimin e tyre. Faqet parlamentare të internetit mundësojnë komunikimin me qytetarët, ndërsa për kategorinë e qytetarëve që kanë qasje të kufizuara në Internet të lehtësohet qasja në informata përmes kanaleve ndërmjetësuese të cilat mund t'i shpërndajnë më tej informatat tek qytetarët. Faqet parlamentare të internetit do të mëtojnë të përdorin mjete interaktive për t'i angazhuar qytetarët dhe për të ofruar njoftime të shpejta për zhvillimet në parlament. Parlamenti do t'i jap preferencë përdorimit të formateve të hapura, si dhe softuerë pa pagesë dhe me burim të hapur. Parlamenti ka obligim të sigurojë informata parlamentare të përdorshme në aspektin e teknologjisë, duke garantuar privatësinë e atyre që iu qasen informatave.

# DEKLARATË PËR TRANSPARENCËN PARLAMENTARE

## Preambulë

Duke pasur parasysh që parlamentet dhe institucionet legjislative përfshirëse, llogaridhënëse, të qasshme dhe të përgjegjshme janë me rëndësi të madhe për demokratizim për shkak të përgjegjësisë të tyre kushtetuese në miratimin e ligjeve, përfaqësimin e qytetarëve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe performancës së ekzekutivit, si dhe pasqyrimin e interesave të qytetarëve;

Duke pasur parasysh që transparenca parlamentare mundëson qytetarët që të informohen për punën e parlamentit, fuqizon qytetarët në procesin legjislativ, bën të mundur që qytetarët të kërkojnë llogari nga parlamentarët dhe siguron përfaqësim të interesave të qytetarëve;

Duke pasur parasysh që të drejtat e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje dhe t'iu qasen informatave parlamentare janë të përcaktuara në kuadër të të drejtave ndërkombëtare të njeriut<sup>2</sup> dhe në standardet dhe normat ndërkombëtare për parlamentet demokratike të miratuara nga komuniteti ndërkombëtar parlamentar<sup>3</sup>; dhe duke pasur parasysh që institucionet ndërkombëtare kanë shtruar një bazë të fortë për transparencë përmes internetit<sup>4</sup>;

Duke pasur parasysh që fillimi i epokës digjitale ka ndryshuar në themel kontekstin e përdorimit publik të informatave parlamentare dhe pritjet e qytetarëve për qeverisje të mirë dhe duke pasur parasysh që teknologjitë e reja fuqizojnë analizat dhe ripërdorimin e informatave parlamentare me premtimin e jashtëzakonshëm të ndërtimit të njohurive të përbashkëta dhe informimit të demokracisë përfshirëse;

Duke pasur parasysh që ndryshimet në tradita, përvojë, resurse dhe kontekst mund të kenë ndikim në qasjen e parlamenteve në përmirësimin e transparencës, ato nuk minojnë rëndësinë e përmirësimit të transparencës parlamentare;

Duke pasur parasysh që nevoja për transparencë parlamentare plotësohet nga nevoja për transparencë më të gjerë qeveritare dhe duke pasur parasysh që shumë qeveri janë duke bashkëpunuar me shoqërinë civile përmes nismave si Partneriteti i Hapur Qeveritar për të zhvilluar zotime të monitorueshme për të pasur qeveri më transparente, efektive dhe llogaridhënëse;

Duke pasur parasysh që një numër gjithnjë më i madh i organizatave të shoqërisë civile për monitorimin dhe mbështetjen parlamentare mëton të luaj një rol domethënës dhe bashkëpunues në fuqizimin e llogaridhënies demokratike të parlamenteve dhe të kërkojë qasje në informata parlamentare për ta luajtur këtë rol në mënyrë efektive, si dhe duke pasur parasysh që ka precedentë të shumtë të bashkëpunimit të

---

<sup>2</sup> Duke përfshirë në nenet 19 dhe 21 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në nenet 19 dhe 25 të Paktit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike.

<sup>3</sup> Këto norma dhe standarde përfshijnë dokumente të krijuara dhe miratuara nga Unioni Ndërparlamentar, Asociacioni Parlamentar i Komonuelthit, Forumi Parlamentar i Komunitetit Afrikanojugor për Zhvillim, *Assemblée parlementaire de la Francophonie*, dhe Konfederata Parlamentare e Amerikës.

<sup>4</sup> Unioni Ndërparlamentar dhe Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Marrëdhënie Ekonomike dhe Sociale. Udhëzimet për faqe parlamentare të internetit, mars 2009.

fortë ndërmjet parlamenteve dhe organizatave për monitorimin e parlamenteve (OMP) që mund të informojnë për përpjekjet për transparencë më të madhe të informatave parlamentare;

Prandaj, përfaqësuesit e komunitetit të OMP-ve<sup>5</sup> kanë hartuar parimet vijuese të transparencës parlamentare dhe janë zotuar t'i avancojnë ato.

## **PROMOVIMI I KULTURËS SË TRANSPARENCËS**

### **1. Pranimi i pronësisë publike mbi informatat parlamentare**

Informatat parlamentare i përkasin publikut; qytetarët duhet të lejohen që t'i ripërdorin dhe ribotojnë informatat parlamentare, në tërësi apo pjesë të tyre. Çdo përjashtim apo kufizim në këtë parim duhet të përkufizohet qartë me ligj.

### **2. Avancimi i një kulture të transparencës përmes legjislacionit**

Parlamenti ka obligim të miratojë ligje dhe rregullore të brendshme të punës dhe kode të sjelljes, të cilat nxisin një mjedis të përshtatshëm për të garantuar të drejtën e opinionit publik në informata parlamentare dhe të qeverisë, duke promovuar një kulture të qeverisë së hapur, duke siguruar transparencë të financave politike, mbrojtur lirinë e shprehjes dhe tubimit, si dhe duke siguruar angazhim të shoqërisë civile dhe qytetarëve në procesin legjislativ.

### **3. Mbrojtja e kulturës së transparencës përmes mbikëqyrjes**

Në përmbushjen e funksionit të tij të mbikëqyrjes, parlamenti garanton që ligjet që sigurojnë transparencë të qeverisë zbatohen në mënyrë të efektshme, se qeveria vepron në mënyrë tërësisht transparente dhe angazhohet në promovimin e kulturës së transparencës.

### **4. Promovimi i edukimit qytetar**

Parlamenti ka përgjegjësi që aktivisht të promovojë edukim qytetar të publikut, veçanërisht të rinisë, duke promovuar të kuptuarit e rregullave dhe procedurave të parlamentit, funksionimin e parlamentit dhe rolin e deputetëve

### **5. Angazhimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile**

Parlamenti ka obligim që aktivisht t'i angazhojë qytetarët dhe shoqërinë civile, pa diskriminim, në proceset parlamentare dhe vendimmarrje, në mënyrë që t'i përfaqësojë efektshëm interesat e qytetarëve dhe të zbatojë të drejtën e qytetarëve në peticione ndaj qeverive të tyre.

### **6. Mbrojtja e shoqërisë së pavarur civile**

Parlamenti ka obligim të mbështesë masa për të siguruar që organizatat e shoqërisë civile janë në gjendje të operojnë lirshëm dhe pa kufizime.

### **7. Mundësimi i monitorimit efektiv parlamentar**

Parlamenti do të njohë të drejtën dhe obligimin e shoqërisë civile, mediave dhe opinionit të përgjithshëm publik për të monitoruar parlamentin dhe parlamentarët. Parlamenti do të angazhohet në

---

<sup>5</sup> Lista e plotë e azhurnuar e organizatave mbështetëse gjendet në: [www.openingparliament.org/organizations](http://www.openingparliament.org/organizations)

konsultime me opinionin e përgjithshëm dhe organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë parlamentin për të nxitur monitorim efektiv dhe evitimin e pengesave për qasje në informatat parlamentare.

#### **8. Ndarja e praktikave të mira**

Parlamenti do të merr pjesë aktivisht në shkëmbimet ndërkombëtare dhe rajonale të praktikave të mira me parlamentet tjera dhe me organizatat e shoqërisë civile për të rritur transparencën e informatave parlamentare, përmirësuar përdorimin e informatave dhe teknologjitë e komunikimit, si dhe fuqizuar respektimin e parimeve demokratike.

#### **9. Sigurimi i referimit juridik**

Parlamenti do të miratojë ligje që sigurojnë që qytetarët kanë qasje efektive në mjete juridike apo gjyqësore në rastet kur qasja e qytetarëve në informata të qeverisë apo parlamentit është çështje kontestuese.

#### **10. Shpërndarja e informatave të plota**

Informatat parlamentare në dispozicion publik do të jenë sa më të plota, duke pasqyruar tërësinë e veprimit parlamentar, duke iu nënshtruar vetëm përjashtimeve të ngushta dhe të përkufizuara qartë.

#### **11. Sigurimi i informatave në kohë**

Informatat parlamentare do të ofrohen për publikun në kohë të duhur. Si rregull i përgjithshëm, informatat do të sigurohen në kohë reale. Në rast se kjo nuk është e mundur, informatat parlamentare do të lëshohen për publikun sa më shpejtë që të jenë në dispozicion të brendshëm.

#### **12. Sigurimi i informatave të**

Parlamenti do të sigurojë një proces të mbajtjes së shënimeve origjinale zyrtare dhe të garantojë që informatat e lëshuara për publikun janë të sakta.

## **INFORMATATA TRANSPARENTE PARLAMENTARE**

#### **13. Miratimi i politikave për transparencën parlamentare**

Parlamenti do të miratojë politika që sigurojnë shpërndarje proaktive të informatave parlamentare, duke përfshirë politika që kanë të bëjnë me formate në të cilat do të publikohen informatat. Politikat e transparencës parlamentare do të jenë në dispozicion publik dhe do të saktësojnë afatet e rishikimit periodik të tyre për t'i shfrytëzuar përparësitë e risive teknologjike dhe praktikave të mira të reja. Nëse parlamentet nuk kanë kapacitete të menjëhershme për t'i publikuar informatat gjithëpërfshirëse parlamentare, parlamenti duhet të zhvillojë partneritete me shoqërinë civile për të siguruar qasje të përgjithshme publike në informata parlamentare.

#### **14. Sigurimi i informatave për rolet dhe funksionet e parlamentit**

Parlamenti do të vë në dispozicion informata lidhur me rolin e tij kushtetues, strukturën, funksionet, rregullat e brendshme, procedurat administrative dhe rrjedhën e punës, si dhe informatat e njëjta për komisionet e tij.

### **15. Sigurimi i informatave për deputetët**

Parlamenti do të sigurojë informata të mjaftueshme dhe informata të përditësuara rregullisht për qytetarët ata t'i kuptojnë më mirë kredencialet e deputetëve, lidhjet partiake, mandatin zgjedhor, rolet në parlament, vijueshmërinë, identitetin e stafit personal, si dhe informatat e tjera që deputetët dëshirojnë të zbulojnë për vete dhe kredencialet e tyre. Informatat kontaktuese të zyrave parlamentare dhe të zyrave në komunitet të deputetëve gjithashtu do të jenë në dispozicion publik.

### **16. Sigurimi i informatave për stafin parlamentar dhe administratën**

Parlamenti do të vë në dispozicion publik informatat lidhur me organizimin dhe funksionimin e administratës dhe strukturën e stafit parlamentar që është i përfshirë në menaxhimin dhe administrimin e proceseve parlamentare. Informatat kontaktuese për stafin përgjegjës për ofrimin e informatave për publikun duhet të jenë në dispozicion publik.

### **17. Informimi i qytetarëve në lidhje me agjendën parlamentare**

Dokumentimi lidhur me orarin e çështjeve parlamentare do të jetë i hapur për publikun, duke përfshirë kalendarin e seancave, informatat që kanë të bëjnë me votimet e caktuara, rendin e ditës, si dhe orarin e seancave dëgjimore të komisioneve. Përveç në raste të rralla që kanë të bëjnë me procedimin e projektligjeve me procedurë urgjente, parlamentet do të ofrojnë njoftim të mjaftueshëm paraprak për të mundësuar komente të publikut dhe shoqërisë civile.

### **18. Angazhimi i qytetarëve në lidhje me projektligje**

Projektligjet do të jenë publike dhe do të shpallen pas miratimit të tyre. Duke njohur nevojën që qytetarët të jenë tërësisht të informuar për çështjet në diskutim dhe të japin kontributin e tyre, parlamenti do të angazhohet që të sigurojë qasje publike në analizat përgatitore dhe informatat paraprake për të nxitur të kuptuar të gjerë të diskutimeve të politikave lidhur me legjislacionin e propozuar.

### **19. Publikimi i procesverbaleve të takimeve të komisioneve**

Raportet e takimeve të komisioneve, duke përfshirë dokumentet e krijuara dhe të pranuar, deklaratat e të ftuarve në seancat dëgjimore publike, transkriptet dhe procesverbalet e takimeve të komisioneve do të vendosen në dispozicion të publikut pa vonesë.

### **20. Regjistrimi i votave parlamentare**

Për të siguruar llogaridhënie të deputetëve para votuesve të tyre, parlamenti do të minimizojë përdorimin e votimit me zë në seancë plenare dhe do të përdorë votim me emër apo me kartela elektronike, duke mbajtur dhe vënë në dispozicion publik një regjistër të votave të deputetëve individual në seanca plenare dhe komisione. Ngjashëm, parlamenti do të minimizojë përdorimin e votimit me autorizim dhe do të sigurojë se ai nuk minon normat e transparencës dhe llogaridhënies demokratike.

### **21. Publikimi i procesverbaleve të seancave plenare**

Parlamenti do të krijojë, mbajë dhe publikojë procesverbale lehtësisht të qasshme të seancave plenare. Preferohet që kjo të jetë në formë të incizimeve audio apo video, të mbajtur në internet në një lokacion të përhershëm, si dhe në formë të transkriptit me shkrim apo transkripteve fjalë për fjalë.

## **22. Publikimi i raporteve të krijuara nga parlamenti apo të siguruara për të**

Të gjitha raportet e krijuara nga parlamenti apo që janë kërkuar apo janë të nevojshme të dorëzohen në parlament, zyrat e tij, apo komisionet, do të jenë publike në tërësi, përveç në rrethanat të përkufizuara ngushtë me ligj.

## **23. Sigurimi i informatave për buxhetin dhe shpenzimet**

Parlamenti ka përgjegjësi t'i publikojë informatat gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të kuptueshme lidhur me buxhetin kombëtar dhe shpenzimet publike, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet e kaluara, aktuale dhe të parashikuara. Ngjashëm, parlamenti ka obligim t'i publikojë informatat lidhur me buxhetin vetjak të parlamentit, duke përfshirë informata lidhur me ekzekutimin e buxhetit dhe kontratave të tij. Këto informata do të jenë publike në tërësinë e tyre, duke përdorur taksonomi të njëtrajtshme, krahas përmbledhjeve në gjuhë të thjeshtë, shpjegimeve apo raporteve që ndihmojnë të kuptuarit nga qytetarët.

## **24. Deklarimi i pasurive dhe sigurimi i integritetit të deputetëve**

Parlamenti do të vë në dispozicion informata të mjaftueshme për t'i mundësuar qytetarët që të nxjerrin gjykime të informuara lidhur me integritetin dhe ndershmërinë e deputetëve individualë, duke përfshirë informata lidhur me deklaratimet e pasurisë, shpenzimet e tyre parlamentare, si dhe të hyrat e tyre jo-parlamentare, duke përfshirë interesat, dividendët, qiratë apo përfitimet e tjera në natyrë.

## **25. Zbulimi i informatave për sjelljen jo etike dhe konfliktet e mundshme të interesit**

Parlamenti do të miratojë rregulla të përkufizuara qartë për të siguruar zbulim të informatave të nevojshme për t'u mbrojtur nga konfliktet aktuale apo të perceptuara të interesit dhe shkeljet etike, duke përfshirë informata lidhur me bashkëveprimet e deputetëve me lobistët dhe grupet e interesit. Parlamenti gjithashtu do t'i publikojë informatat lidhur me rezultatet përfundimtare të çdo hetimi gjyqësor apo parlamentar të akuzave për sjellje joetike, konflikte të interesit apo korrupsion.

## **26. Sigurimi i qasjes në informata historike**

Informatat parlamentare për seancat paraprake do të digjitalizohen dhe do të ofrohen në dispozicion për qytetarët për ripërdorim të vazhdueshëm pa pagesë dhe pa kufizime ligjore. Nëse një parlament nuk mund të digjitalizohet dhe t'i vë në dispozicion informatat e tij, ai do të punojë me organizata të jashtme për të lehtësuar shpërndarjen publike të informatave parlamentare pa kufizime. Parlamenti do të sigurojë qasje publike në biblioteka parlamentare për t'i mundësuar deputetëve dhe publikut që të kenë qasje në informatat historike parlamentare.

# **LEHTËSIMI I QASJES NË INFORMATA PARLAMENTARE**

## **27. Sigurimi i kanaleve të shumta për qasje në informata**

Parlamenti do të sigurojë qasje në informata lidhur me punën e tij përmes kanaleve të shumta; duke përfshirë vëzhgimet personale, mediat e shkruara, transmetimet në radio dhe televizion, si dhe në internet dhe teknologji mobile.

## **28. Sigurimi i qasjes fizike**

Parlamenti dhe seancat plenare të tij do të jenë fizikisht të qasshme dhe të hapura për të gjithë qytetarët, në pajtim me kufizimet e dëshmuara të sigurisë publike dhe të hapësirës.

### **29. Garantimi i qasjes nga mediat**

Parlamenti do të sigurojë që mediat dhe vëzhguesit e pavarur të kenë qasje të plotë në procedurat parlamentare. Kriteret dhe procesi për sigurimin e qasjes së mediave do të përkufizohet qartë dhe do të jenë në dispozicion publik.

### **30. Sigurimi i transmetimit të drejtpërdrejtë dhe me kërkesë, si dhe *streaming***

Do të bëhen përpjekje për t'iu siguruar qytetarëve qasje arkivore në kohë reale dhe me kërkesë në seancat parlamentare përmes radios, televizionit dhe internetit.

### **31. Lehtësimi i qasjes në tërë territorin e vendit**

Për aq sa është e mundur, qasja në informatat parlamentare nuk duhet të kufizohet në bariere gjeografike. Ndonëse përdorimi i faqeve parlamentare të internetit lehtëson qasjen në informata parlamentare pa kufizime gjeografike, në vendet me qasje dhe përdorim më të kufizuar të internetit parlamentet do të kërkojnë mjete të tjera të sigurimit të qasjes publike në informata parlamentare në tërë vendin.

### **32. Përdorimi i gjuhës së thjeshtë**

Parlamentet sigurojnë se gjuha juridike apo teknike nuk shërben si pengesë për qytetarët që kërkojnë qasje në informatat parlamentare. Duke njohur nevojën e përdorimit të gjuhës precize në hartimin e ligjeve, parlamenti ka obligim të hartojë përmbledhje në gjuhë të thjeshtë dhe mjete të ngjashme për t'i vënë informatat parlamentare në dispozicion të lehtë dhe të kuptueshme për deputetët dhe qytetarët me prapavija dhe ekspertiza të ndryshme.

### **33. Përdorimi i gjuhëve zyrtare apo të punës**

Nëse kushtetuta apo rregullat parlamentare përcaktojnë përdorimin e me shumë se një gjuhe zyrtare apo të punës në parlament, parlamenti do t'i bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të sigurojë përkthim simulant të seancave dhe përkthim të shpejtë të transkriptove.

### **34. Qasja e lirë dhe pa pagesë**

Informatat parlamentare do të jenë në dispozicion për qytetarët për qasje të pakufizuar, ripërdorim dhe ndarje pa pagesë.

## **MUNDËSIMI I KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK TË INFORMATAVE PARLAMENTARE**

### **35. Sigurimi i informatave në formate të hapura dhe të strukturuar**

Informatat parlamentare do të përmblihen dhe lëshohen në format të hapur të strukturuar, si XML i strukturuar, që mund të lexohet dhe përpunohet nga kompjuterët, në mënyrë që informatat parlamentare të mund të ripërdoren dhe analizohen lehtësisht nga qytetarët, shoqëria civile, sektori privat dhe qeveria.



### **36. Sigurimi i përdorshmërisë teknologjike**

Parlamenti do të sigurojë që përdorshmëri teknologjike të informatave parlamentare duke siguruar udhëzime të qarta për përdorim të të gjitha bazave të të dhënave në internet apo veglave që mundësojnë qytetarët t'i nxjerrin informatat parlamentare nga faqja e internetit. Në rast se parlamenti siguron interfejs për përdorues, ai do të përdor praktikat më të mira për ta përmirësuar përdorshmërinë e tij.

### **37. Mbrojtja e privatësisë së qytetarëve**

Faqet parlamentare të internetit do të kenë politikë të qartë dhe koncize të privatësisë për t'i informuar qytetarët se si do të përdoren informatat e tyre personale. Parlamenti nuk do të aplikojë anëtarësi apo kërkesa për regjistrim që kufizojnë qasjen publike në informata në faqet e internetit dhe nuk do të lejojnë përcjelljen e informatat personale pa pëlqimin eksplisit.

### **38. Përdorimi i formateve të hapura dhe softuerëve me burim të hapur**

Parlamenti do t'i japë preferencë lëshimit të informatave digjitale në formate të hapura dhe përdorimit të aplikacioneve softuerike pa pagesë dhe me burim të hapur.

### **39. Lejimi i mundësisë së shkarkimit për ripërdorim**

Informatat parlamentare do të jenë të lehta për t'u shkarkuar, në masë dhe në formate të dokumentuara mirë për të lejuar ripërdorim të lehtë të informatave.

### **40. Mirëmbajtja e faqeve parlamentare të internetit**

Edhe në vendet me përdorim të kufizuar të internetit, mirëmbajtja dhe azhurnimi i rregullt i faqes gjithëpërfshirëse të internetit të parlamentit është aspekt jetik i transparencës parlamentare në botën e ndërlidhur moderne. Parlamenti do të sigurojë që informatat parlamentare të jenë në dispozicion në format elektronik dhe shpërndarjen elektronike në internet do ta konsiderojë si mjet thelbësor të komunikimit.

### **41. Përdorimi i mekanizmave të lehtë dhe stabil të kërkimit**

Parlamenti do ta bëjë sa më të lehtë për qytetarët që shpejtë ta gjejnë informatën e dëshiruar parlamentare duke krijuar baza të të dhënave duke mundësuar kërkime të thjeshta dhe komplekse përmes përdorimit të metadatave të duhura. Informatat do të jenë në dispozicion në një lokacion që mbetet i pandryshuar përgjatë kohës, për shembull, në një faqe të internetit vazhdimisht me një URL të njëjtë.

### **42. Lidhja e informatave të ndërlidhura**

Parlamenti do të bëjë përpjekje që të përmirësojë mundësinë që qytetarët t'i gjejnë informatat përkatëse parlamentare duke lidhur informatat parlamentare me informatat tjera përkatëse, për shembull, duke lidhur referencat në historinë e një projektligji me versionet e mëhershme të ligjit, raportet përkatëse të komisionit, deklaratat e ekspertëve, ndryshimeve të sponsorizuara dhe pjesëve të transkripteve që përmbajnë shënime të debateve parlamentare për pjesë të caktuara të ligjit.

### **43. Mundësimi i përdorimit të shërbimeve të lajmërimit**

Kudo që të jetë e mundur, parlamenti duhet t'i sigurojë qytetarëve mundësi që të abonohen në shërbimet të cilat i lajmërojnë ata për veprime të caktuara parlamentare me SMS apo postë elektronike, apo teknologji të tjera.

#### **44. Lehtësimi i komunikimit të dyanshëm**

Parlamenti do të përpiqet që të përdorë mjete teknologjike interaktive për të mundësuar që qytetarët të japin kontribute domethënëse në aktivitetet legjislativë dhe parlamentare dhe për të lehtësuar komunikimin me deputetët apo stafin parlamentar.